



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Prishtinë - Vendimi nr.71/2020

Data: 17.11.2020

Duke u bazuar në Neni 28, 29 dhe çështjet procedurale, të përcaktuara sipas nenit 13,15,17,19,20,35,50,54 paragrafi 1.3 të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe Neni 8 i Plotësim Ndryshimit të Ligji nr. 04/L-226, Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018, neni 18 dhe 20 paragrafi 1.3 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 17.11.2020, mori këtë;

V E N D I M

- I. LEJOHET**, Përqendrimi i ndërmarrjeve nga dhe ndërmjet Euroimpex d.o.o, dhe mbi “Opel Automotive S d.o.o për blerjen e 100% të kuotave, Euroimpex d.o.o është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut, e regjistruar me Nr. të regjistrimit 4135059, me seli në 72 Bulevar treta makedonska brigade Shkup.
- II. Southeast Europe LLC** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me Nr. të regjistrimit 13-09-087612, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, me seli në H-2040 Budaors Szabadsat ut 117 Hungari. **Opel Automotive S d.o.o**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me Nr. të regjistrimit 211598232, e themeluar sipas legjislacionit të Serbisë, me adresë Vladimira Popovica 6, floor 1, number A 105-2 Beograd i Ri, Serbi. Në tregjet e jashtme, përkatësisht në territorin e Republikës së Kosovës Euroimpexd.o.o, dhe Southeast Europe LLC, nuk ka filiale të regjistruara por veprojnë vetëm përmes shitjeve.
- III. Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim**, obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 20 të Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja (tre mijë euro).

A R S Y E T I M

I. PROCEDURAT E NDJEKURA NGA AUTORITETI:

1. Më, datë 25.09.2020 Autoriteti ka pranuar kërkesën e Njoftimit për Përqendrim nga Euroimpex d.o.o, dhe Southeast Europe LLC përmes fitimit të kontrollit, apo blerjes së 100% të kuotave.
2. Kërkesa është paraqitur në bazë të Ligjit Nr.03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi, Ligji Nr. 04/L-226, Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve.
 - a. Njoftimi i përqendrimit në Web Faqen e Autoritetit me datën 30.10.2020,

- b. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 02.11.2020.
- c. Autoriteti, ka bërë vlerësimin e qëllimit të realizimit të Përqendrimit sipas procedurës së shkurtër, për arsye se nga ky transaksion nuk do të krijohet pozitë dominuese në tregun e Republikës së Kosovës.

Njoftimi për Përqendrim ka të bëjë me:

3. Përqendrimi, do të realizohet nga ndërmarrjet, Euroimpex d.o.o, dhe Southeast Europe LLC, e cila është pronare e 100% e të gjitha aksioneve të Opel Automotive S d.o.o
4. **Blerësi:** Euroimpex d.o.o është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut, e regjistruar me Nr. të regjistrimit 4135059, me seli në 72 Bulevar treta makedonska brigade Shkup. Euroimpex është importuesi dhe shpërndarësi kryesor i automjeteve Peugeot.
5. **Shitësi:** Southeast Europe LLC është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me Nr. të regjistrimit 13-09-087612, sipas legjislacionit të Hungarisë, me seli në H-2040 Budaors Szabadsat ut 117 Hungari. Shitësi vepron si importues dhe shpërndarës i automjeteve Opel dhe pjesëve të këmbimit, paisjeve shtesë dhe aksesoreve për markat Opel dhe Chevrolet, në territorin e Evropës Juglindore. Shoqëria realizon të ardhura në Republikën e Kosovës.
6. **Targeti:** Opel Automotive S d.o.o, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me Nr. të regjistrimit 211598232, e themeluar sipas legjislacionit të Serbisë, me adresë Vladimira Popovica 6, floor 1, number A 105-2 Beograd i Ri, Serbi. Targeti është ndërmarrje me qëllime të veçanta, e themeluar në vitin 2020, dhe e zotëruar nga Opel Southeast Europe LLC, për qëllime të këtij transaksioni. Aktiviteti i Opel Automotive S d.o.o., do të jetë tregtimi i automjeteve dhe mjeteve motorike të lehta, shitje me pakicë e pjesëve të këmbimit dhe paisjeve të mjeteve motorike. Targeti nuk ka degë të regjistruar në Republikën e Kosovës.

II. BAZA LIGJORE DHE AKTI I PËRQENDRIMIT

7. Bazuar në nenin 15, të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, palët kanë përmbushur detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:
 - a. Qarkullimi i kombinuar i palëve është sipas dispozitës përkatëse, të Ligjit.
 - b. Blerësi dhe shitësi janë prezent në Republikën e Kosovës përmes shitjeve.
 - c. Kontrata e Shitblerjes, datë 04.09.2020.

III. ANALIZA E TREGUT

Tregu Relevant

- **Tregu i produktit**, përfshin importin dhe shpërndarjen e automjeteve Opel, dhe (Opel, Chevrolet) pjesëve të këmbimit, paisjeve dhe aksesoreve dhe shërbimeve të tjera të ngjashme.

Duke i'u referuar praktikave të Komisionit Evropian, në çështje të ngjashme, tregu i produktit do të mbetet i hapur.

- **Tregu gjeografik** në transaksionin e propozuar do të konsiderohet, territori i Republikës së Kosovës.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar

8. Përqendrimi, është propozuar në Maqedoninë e Veriut, por kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se blerësi është prezent përmes shitjeve dhe nuk kanë degë të regjistruar në Republikën e Kosovës, dhe transaksioni si i tillë nuk ka mundësi të bëjë



ndryshim në strukturën (horizontale apo vertikale të tregut, në Republikën e Kosovës). Autoriteti, shqyrtoi dhe arriti në përfundim, se nuk ka efekte negative nga realizimi i këtij transaksioni sepse Përqendrimi, nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këtë arsye, transaksioni i synuar, nuk do të sjellë asnjë ndryshim e rrjedhimisht, nuk do të ketë ndikim në tregun e Republikës së Kosovës.

Vëmendje:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

**AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
KOMISIONI**


Valon PRESTRESHI
Kryetar


Ahmet KRASNIQI
Zv. Kryetar


Fatime HAZIRI
Komisionere


Muhamet KRASNIQI
Komisioner


Shaqir MORINA
Komisioner

